

EZSELECTTM **PLUS**

**EZSELECTTM PLUS SISTEM
I ZGJEDHJES SË BATERISË**



MANUALI I PËRDORUESIT

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
Pjesët e sistemit	
Pjesët individuale	4
Pjesët e këmbimit	5
Planifikimi / përcaktimi i punës	
Përmbledhje e instalimit	7
Mjetet që nevojiten	7
Disponueshmëria e energjisë	7
Kutia e kontrollit	8
Pajisjet e monitorimit të karikuesve (CMD)	8
Kërkesat për kabllot e të dhënave	8
Konsideratat për ruterin	8
Konsideratat për drajverin e TV	8
Instalimi dhe vënia në punë	9
Lista e kontrollit para instalimit	9
Instalimi	
Përmbledhje e instalimit	10
Kutia e kontrollit dhe instalimi i CMD	11
Instalimi i UPS dhe ruterit	12
Instalimi i drajverit të TV	13
Instalimi i altoparlantit të jashtëm (opsional)	14
Etiketimi i sistemit	14
Konfigurimi i sistemit	
Ekranin me prekje	15
Kodi për të aksesuar cilësimet	15
Ndryshimi i kodeve	15
Konfigurimi i grupimeve dhe karikuesve	16
Rregullimi i volumit	17
Grupimet e ekranit	17
Vënia në punë e sistemit të errët	18
Kontrolli dhe testimi përfundimtar	
CMD	19
Karantina	19
Lista e CMD	20
Testi i alarmit	20
Lista e kontrollit të instalimit	21
Funksionimi	
Zgjedhja e baterisë tjetër të disponueshme	22
Reagimi i sistemit	22
Treguesit LED vizualë të CMD	22
Ekranin me prekje	23
Kontrollet ditore të sistemit ose për çdo turn	26
Lista e kontrollit të operimit	27
Zgjidhja e problemeve	28

EZSELECTTM PLUS

Sistemi i zgjedhjes së baterisë EZSelectTM Plus ndihmon për të rritur në maksimum performancën e dhomës së baterisë. Jo vetëm që përmirëson procesin e zgjedhjes së baterive të duhura gjatë ndryshimit të baterive, por siguron informacion të rëndësishëm menaxhimi lidhur me bateritë dhe karikuesit.

Një sistem i instaluar plotësisht do të ketë një pajisje të monitorimit të karikuesve të montuar mbi çdo karikues. Kjo pajisje monitorimi quhet gjithashtu CMD. Funkcioni kryesor i CMD është të dallojë se kur karikuesi mbaron karikimin dhe ta dërgojë këtë informacion te kutia e kontrollit. Kutia e kontrollit është e lidhur me të gjitha CMD-të dhe përdor informacionin e marrë nga këto CMD për të monitoruar të gjitha bateritë e karikuara. CMD-të/karikuesit janë të grupuar në njësi të quajtura Grupime.

Çdo Grupimi i është dedikuar një lloji/madhësie të caktuar të baterisë në kompleks. Funkcioni tjetër i kutisë së kontrollit është të informojë operatorin se cilën bateri të zgjedhë për të siguruar efikasitet maksimal. Ky informacion transmetohet përmes një ekrani të montuar në kutinë e kontrollit, një Shouteri që i lajmëron mesazhet operatorit, dhe dritave LED me ngjyra të montuara në CMD.

Për shërbime, kontaktoni përfaqësuesin e shitjeve:

EnerSys[®] EMEA Headquarters

Telefon:

+41 44 215 74 10

Adresa:

EH Europe GmbH
Baarerstrasse 18,
6300 Zug, Zvicër

**Siguria juaj dhe siguria e të tjerëve
është shumë e rëndësishme**


⚠ KUJDES Mund të vriteni ose të lëndoheni rëndë nëse nuk ndiqni udhëzimet.



PJESËT E SISTEMIT

Pjesët individuale

Figura 1: Përmbledhje e sistemit të zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Plus



PJESËT E SISTEMIT

Pjesët e këmbimit



EZS-CB6700EU-16

Sistemi i zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Plus
Kutia e kontrollit
(Maks. 350 karikues; Maks. 9 grupime)



EZS-143

Kablllo të dhënash 8 m me një bashkues



EZS-161

Kablllo të dhënash 30 m me një bashkues
(Minimumi 2 për çdo kuti kontrolli, lidhje bus me CMD të parë)



EZS-SU600R

Pajisja e monitorimit të karikuesve (CMD)
(Kablllo të dhënash 2,1 m për çdo CMD të përfshirë)



EZS-511

Bateria UPS rezervë



EZS-ROU

Route
(Të gjithë kabllot të përfshirë)



EZS-HDS6N2

Drajveri i TV
(Të gjitha kabllot dhe një maus të përfshirë)

PJESËT E SISTEMIT

Pjesët e këmbimit (opsionale)



EZS-SH6000

Altoparlanti i jashtëm
(15 m kablo altoparlanti i përfshirë)



EZS-231

Splitter Kit për ekranin e monitorit TV

Përmbledhje e instalimit

Instalimi në vend mund të ndahet në tre faza:

- 1. Kutia e kontrollit**
 - a. Kutia e kontrollit
- 2. Lidhjet me tela të CMD**
 - a. Montimi në karikues
 - b. Lidhja nga kutia e kontrollit në CMD të parë
 - c. Lidhja nga CMD në CMD
 - d. Emërtimi i blloqeve të karikuesve/baterive
- 3. Ruteri dhe drajveri i TV**
 - a. Lidhja e ruterit
 - b. Lidhja e drajverit të TV
- 4. Konfigurimi i karikuesve/testimi përfundimtar**
 - a. Konfigurimi i Grupimeve
 - b. Konfigurimi i karikuesve
 - c. Testimi i kapacitetit të ngarkimit
 - d. Trajnimi i operatorit


Mjetet e nevojshme



Trapan dhe
punto



Vida dhe upa
të përshtatshme
për montimin



Niveli



Kaçavidë



Pinca prerëse

Disponueshmëria e energjisë

Kërkesat për energji të pjesëve të sistemit të zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Plus:

Kutia e kontrollit

Tensioni: 100-240 VAC

Amperazhi: 1,3 A

Ruteri

Tensioni: 100-240 VAC

Amperazhi: 0,6 A


Udhëzime të planifikimit të hapsirës që duhen marrë në konsideratë

Kordonët zgjatues mund të përdoren përkohësisht, megjithatë rekomandohet fort mbrojtje nga mbingarkesa për kutinë e kontrollit.

Kutia e kontrollit

- Kutia e kontrollit duhet të vendoset në një pozicion qendror me hapësirë të mjaftueshme që ruteri (EZS-ROU1) të instalohet pranë. Sigurohuni që të ketë hapësirë të mjaftueshme anembanë kutisë së kontrollit për të lidhur kabllot, përmasat tregohen në figurën 2.
- Montojeni në një vend të dukshëm, pa pengesa.
- Mbajini pjesët larg nga burimet e ujit, si për shembull dushet dhe lavamanët.
- Kutia e kontrollit merr energji nga njësia EZS-ROU1.
- Përdorni upa të përshtatshme sipas nevojës për të mbajtur kutinë e kontrollit (6,8 kg).

Figura 2: Përmasat e kutisë së kontrollit



Pajisjet e monitorimit të karikuesve (CMD)

Nevojitet një CMD për çdo karikues. CMD universal mund të përdoret për çdo tension nga 12 V deri në 80 V.

Konsideratat për ruterin

Trupi i ruterit (iHUB-ROU1) mban si ruterin ashtu edhe UPS-në për kutinë e kontrollit, ndaj është e rëndësishme që të mbyllet kutia e kontrollit dhe një burim energjie 240 V.

Konsideratat për drajverin e TV

Drajveri i TV duhet të montohet jo më larg se 3 m nga kutia e kontrollit. TV duhet të montohet pranë një burimi energjie të përshtatshme dhe të jetë në lartësi të mjaftueshme që të jetë lehtësisht i dukshëm për operatorët.

Kërkesat për kabllon e të dhënave

Kabllot e të dhënave lidhin kutinë e kontrollit me CMD. Kur planifikoni një instalim, gjatësitë e kabllave duhet të mbahen në minimum. Me çdo kuti kontrolli do të keni:

- 4 kablllo 15 m
- 4 bashkues kablllosh

Distanca midis kutisë së kontrollit dhe CMD të parë është shumë e rëndësishme. Dy shembuj të kabllave bus tregohen në Figurën 3.

Bus 1: Nevojiten 15 m kablllo edhe pse largësia nga kutia e kontrollit në CMD-në e parë është vetëm 3 metra.

Bus 2: Nevojiten 30 m kablllo pasi ajo ndodhet në anën tjetër të ishullit në CMD-në e parë.

Instalimi dhe vënia në punë

Sistemi i zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Plus është projektuar që të mos ketë nevojë për vënie në punë nga EnerSys®, por nëse nevojitet ndihmë, ajo ofrohet me kërkesë. Në internet gjenden video për instalimin.


Lista e kontrollit para instalimit

Detyra	Statusi
A. Planifikoni vendndodhjen e kutisë së kontrollit dhe ruterit	
- Energjia për kutinë e kontrollit dhe ruterin - Pranë karikuesve - Planifikoni për kalimin e kablllove të të dhënave në CMD e parë në çdo bus	☐
B. Mblidhni të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme	
- Shkallë dhe/ose ashensor gërshërë - Mjete me korrent - për montimin e kutisë së kontrollit, etj. - Mjete dore - pinca, kaçavidë - Kordonë zgjatues për energji të përkohshme - Upa për montimin e pjesëve sipas nevojës	☐

Instalimi


[illegible]

Instalimi



Instaloni mbajtësin e drejtë

Instaloni mbajtësin e drejtë në mur në lartësinë e syrit duke përdorur katër vida/ankera dhe një nivelë.




Instaloni kutinë e kontrollit

Futni kutinë e kontrollit në kllapë.




Instaloni kutinë e kontrollit


Montoni kutinë e kontrollit në mur në lartësinë e syrit duke përdorur katër vida/upa dhe një nivel.




Futni kabllon e të dhënave të CMD-së së parë nga porta e poshtme në një prej foleve bus të disponueshme në kutinë e kontrollit.



Futni kabllon e të dhënave të CMD-së së parë në një fole në CMD-në e parë. Lidhni kabllon tjetër të të dhënave në një fole tjetër.




Montoni CMD-në me fasheta në mënyrë që të jetë e dukshme, e mbrojtur dhe e sigurt. Lidhni CMD-të në seri derisa të gjitha CMD-të në bus të jenë lidhur.



Lidhni dy FlexiTaps në anët e konektorit.

Vendoseni konektorin midis kabllave pozitive dhe negative.

*Sigurohuni që të jenë lidhur fort me konektorin dhe kabllot, kunjat të jenë në mes të kabllave dhe të që mos përthyeren kunjat.




Fiksojeni konektorin me stega. Konfirmoni që drita LED portokalli ndizet në CMD me një bateri të lidhur.

INSTALIMI


Instalimi i UPS dhe ruterit




Montoni kutinë e ruterit pranë kutisë së kontrollit dhe një furnizimi të përshtatshëm me energji duke përdorur katër vida, upa të përshtatshme dhe një nivelë.




Vendoseni baterinë UPS rezervë në kasë, lidhjeni me burimin e energjisë dhe lidhjeni kordonin e energjisë së kutisë së kontrollit në UPS.



Ndizeni UPS-në.




Lidhni dy antenat Wi-Fi me konektorët Wi-Fi të ruterit.




Lidhni dy antenat me kablllo me konektorët mobilë të ruterit. Vendosni një sipër kutisë së kasës, dhe tjetrin sa më lart të jetë e mundur.

*Lini të paktën 1 m distancë midis dy antenave me kablllo.



Lidhni kabllot e të dhënave nga një prej foleve të disponueshme në kutinë e kontrollit me portën LAN Ethernet në ruter.



Lidhjeni ruterin me energjinë.


Pasi të keni instaluar kutinë e ruterit, UPS-në dhe të keni ndezur të gjithë komponentët, prisni pesë deri në dhjetë minuta që të krijohet lidhja dhe më pas rindizeni kutinë e kontrollit.

Për të bërë këtë, shkoni te "Settings", "Internet" dhe "Reboot". Tani jeni gati të bëni një test të ngarkimit të të dhënave. Në të njëjtin ekran të cilësimeve të internetit, shtypni butonin "Upload Now" dhe dilni.

Pas pesë minutash shtypni butonin Status në ekranin kryesor dhe në cepin e poshtëm të majtë do të shihni "Time Since Last Upload". Kjo duhet të bëhet brenda 5 minutash.


INSTALIMI

Instalimi i drajverit të TV




Montoni drajverin eTV në mur duke përdorur katër vida/upa dhe një nivelë.


*Ruani distancën midis kutisë së kontrollit dhe drajverit të TV nën 2,5 m për t'u siguruar që të ketë lidhje të mirë.



Lidhni drajverin eTV me folenë "Remote iDisplay" në kutinë e kontrollit.




Lidhni kabllo HDMI me drajverin eTV dhe monitorin eTV*.



Lidhni drajverin eTV me burimin e energjisë.

Radha e nisjes



ON




ON




Ndizeni TV, pas 5 minutash me kutinë e kontrollit të ndezur, ndizeni drajverin eTV.

INSTALIMI

Instalimi i shouterit të jashtëm (opsional)



Montoni altoparantin e jashtëm sipër kutisë së kontrollit brenda 15 m të kablos audio të dhënë.



Lidhni dy fijet në prizat e jashtme të altoparantit në kutinë e kontrollit.

Etiketimi i sistemit

Sistemi i zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Plus komunikon me operatorin duke referencuar një numër karikuesi. Është gjithnjë e rëndësishme ta mbani sistemin e numrave të karikuesve të organizuar që procesi i zgjedhjes së një baterie të jetë pa vështirësi.

Kur konfiguroni sistemin e numrave të karikuesve në kompleks, rekomandohet të ndiqni një format me 3 shifra (siç tregohet në të gjithë shembujt në këtë manual) ku shifra e parë i referohet grupimit, dhe shifra e dytë dhe e tretë i referohet numrit të baterisë në atë grupim.

Një grupim është një grup baterish të cilat janë grupuar sipas llojit, p.sh. Powered Pallet Trucks dhe Reach Trucks. Si rregull bazë i organizimit të baterive, do të ketë gjithnjë të paktën një grupim për çdo lloj baterie në kompleks. Ka disa raste në të cilat do të ishte mirë pasja e më shumë se një grupimi për çdo lloj baterie. Sistemi i zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Plus ka gjithsej 9 grupe të disponueshme.

Si ekrani i TV ashtu edhe ekrani në kutinë e kontrollit duhet të përputhen me emërtimet e karikuesve që ia bëjnë më të lehtë operatorit të shkojë te bateria e duhur. Më poshtë tregohet një shembull.

PALLET	REACH
101	201
102	202
103	203

Shembull i organizimit me 3 shifra

*Etiketat e karikuesve do të jepen me çdo sistem të zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Plus.


KONFIGURIMI I SISTEMIT

Ekrani me prekje

Sinjal që tregon komunikimin mes ekranit dhe kontrollorit.


Bateria tjetër për t'u marrë për secilën prej grupimeve.

*Ekrani kryesor do të shfaqë automatikisht deri në grupe.




Klikoni butonin "To Do" nëse bëhet i kuq - Kontrolloni nëse karikuesit janë në karantinë ose nëse CMD nuk raporton.

Kodi për të aksesuar cilësimet




Klikoni **Settings** në ekranin kryesor.




Vendosni kodin standard **919191** më pas klikoni **OK**.

Ndryshimi i kodeve



Klikoni **Settings Passcode** ose **Maint Mode Passcode**.




Vendosni **New Passcode**# më pas klikoni **OK**.

*Nëse preferoni të hiqni kodin(et) gjatë instalimit, lëreni bosh dhe klikoni OK. Rekomandohet të vendosni kodin para se të largoheni nga vendi.


#Fjalëkalimi(et) mund të rikuperohet nga EnerSys® nëse ju humb duke kontaktuar departamentin e duhur rajonal dhe duke i dhënë numrin e serisë së kutisë së kontrollit.

KONFIGURIMI I SISTEMIT


Konfigurimi i grupimeve dhe karikuesve




Klikoni **Pools & Chargers** te menyja e cilësimeve.




Klikoni çelësin e grupimit të parë bosh dhe shkruani emrin e grupimit.




Vini re që tani emri i grupimit është vendosur. Klikoni butonin **Set V** që përket me tensionin e grupimit.




Zgjidhni tensionin e duhur të grupimit.



Shtoni karikues në grupim.



Shkoni te karikuesi. Shkëputni dhe lidhni sërish karikuesin që doni të shtoni.




Shënoni numrin për të vendosur ID-në e karikuesit.
*Ky ekran do të shfaqet kur sistemi i zgjedhjes së baterisë EZSelect™ Plus dallon baterinë e lidhur.


Përsëritni hapin 1 deri në 6 për të konfiguruar grupime dhe karikues të tjerë.

Vini re: Ky është numri që do të shfaqet në TV. Duhet të përputhet gjithashtu me emërtimet e karikuesve.

Rregullimi i volumit




Klikoni **Volume** nën menynë e cilësimeve.




Vendosni volumin në vlerat midis 0 (heshtur) dhe 5 (maksimum).
Butoni i testit do t'i bjerë alarmit një herë.

Shfaqni Grupimet



Klikoni **Display Pools** në menynë e cilësimeve.




iDisplay është vendosur që t'i shfaqë të gjitha si opsion standard, megjithatë mund të zgjidhni të shfaqen vetëm grupime të caktuara.


Vënia në punë e sistemit në modalitetin e studimit

Për të llogaritur dobisht e sistemit të zgjedhjes së baterisë EZSelect™, sugjerohet që të filloni me një periudhë bazë prej dy javësh ku sistemi mbledh një model fillestar të të dhënave të përdorimit bazë. Rekomandohet në çdo instalim të ri që të shfaqet një “para dhe pas” e qartë. Vënia në punë e sistemit në modalitetin


e studimit nënkupton që sistemi mbledh informacion pro nuk ka drejtim të dhënë për zgjedhjen e baterisë. Në këtë mënyrë mund të kuptoni se çfarë ndodh vërtet në dhomën e baterive, në mënyrë që të krahasoni të dhënat e papërpunuara me performancën e përmirësuar pasi sistemi të japë komandat.



Klikoni **Sentinel Outputs** nën menynë e cilësimeve.
(Vini re: Një CMD referohet si një Sentinel në softuerin e panelit.)



Vendoseni si **Blue Light** ashtu edhe **Output Relay** në pozicionin **OFF**.



Fikeni iDisplay duke shtypur butonin e energjisë përpara kutisë së kontrollit. Kjo do të çaktivizojë gjithashtu tingullin.

Vini re: Për ta bërë sistemin që të funksionojë normalisht, përsëritni hapat e mëparshëm.

PAJISJA E MONITORIMIT TË KARIKUESVE (CMD)

Nëse e keni vënë në punë me sukses ndihmësin e instalimit për të gjitha CMD-të, atëherë drita LED jeshile do të qëndrojë ndezur te secila.

Nëse doni të kontrolloni edhe një herë lidhjen, mund ta shkëputni një bateri nga një karikues dhe më pas të shihni ekranin e statusit të

sistemit. Duhet të shihni ID-në e karikuesit. Nëse nuk e shihni grupimin dhe ID-në e karikuesit që prisnit, atëherë sistemi mund të mos jetë konfiguruar mirë.

ID-ja e karikuesit do të lëvizë nga kolona në kolonë ndërsa statusi ndryshon.


KARANTINA

Kolona Karantina tregon sasinë e karikuesve që nuk janë vënë në punë ose që nuk e kanë përfunduar karikimin e një baterie që është lidhur me të për 24 orë. Sistemi e karantinon baterinë duke e hequr nga radha, dhe nëse problemi nuk zgjidhet brenda 72 orësh, bateria kthehet në radhë.


3 ditë është konfigurimi standard i fabrikës.

Çfarë të bëni nëse një karikues nuk shfaqet te karantina:

- Nëse ndonjë ID karikuesi listohet te kolona me emrin "Karantina", kontrolloni për të parë nëse karikuesi tregon ndonjë defekt.
- Konfirmoni që drita LED portokalli është e ndezur në CMD, dhe që një bateri është lidhur.
- Nëse ekрани dhe të gjitha dritat treguese në karikues janë bosh, kontrolloni për të parë nëse në karikues ka energji.
- Nëse karikuesi funksionon siç duhet, kontrolloni tensionin e baterisë pasi disa karikues nuk e njohin një bateri që është shkarkuar tepër.
- Për ta hequr baterinë nga Karantina, shkëputeni dhe lidhjeni baterinë sërish.




Klikoni **Quarantine**.




Rritni ose ulni numrin e ditëve të kaluara para se një karikues të vihet te Karantina.

LISTA E CMD




Klikoni **Sentinel List**.
(Vini re: Një CMD referohet si një Sentinel në softuerin e panelit.)



Shtypni **Blue ON** për të gjetur CMD-në e duhur dhe kontrolloni detajet.

Një CMD mund të lëvizet në një Grupim tjetër duke lëvizur nëpër **Pool ID**. Numri i karikuesit mund të ndryshohet duke shtypur **Charger ID**.


Shtypni **Blue OFF** kur janë bërë korrigjime.



Ky tregon numrin e CMD-së së pacaktuar. Shtypni shigjetën në anën e djathtë për të modifikuar detajet e CMD-së.

Ky funksion mund të përdoret gjithashtu për të programuar CMD. Nëse e dini numrin e serisë të CMD-së, mund ta caktoni në një grupim t'i jepni një ID karikuesi. Më pas mund të verifikoni që është e saktë dhe që të gjitha komunikimet punojnë duke ndezur dhe fikur dritën blu.

Testi i shouterit



Testoni funksionimin e shouterit ose duke shkëputur një bateri ose duke shtypur butonin **Test** në ekranin e rregullimit të volumit.

LISTA E KONTROLLIT TË INSTALIMIT

Detyra	Statusi
1. Sigurohuni që të gjitha CMD-të shfaqin një dritë jeshile solide.	☐
2. Sigurohuni që të gjitha CMD-të janë caktuar që raportojnë nëpërmjet CMD List nën Cilësimet në ekranin kryesor.	☐
3. Testoni shouterin për tingujt e baterive "Correct" dhe "Incorrect" nga menyuja. Testojeni këtë duke klikuar "Settings" më pas "Volume." Gjithashtu zgjidhni volumin e dëshiruar.	☐
4. Testoni aftësitë e ngarkimit të sistemit të zgjedhjes së baterisë EZSelect™ nëpërmjet internetit.	☐
5. Nëse fjalëkalimet janë çaktivizuar gjatë instalimit, rivendosni fjalëkalimin standard të Mirëmbajtjes në "1111" dhe fjalëkalimin standard të Cilësimeve në "919191". Ose vendosni fjalëkalimet sipas dëshirës.	☐
6. Kontrolloni që data dhe ora janë vendosur saktë.	☐
7. Kontrolloni që të gjithë karikuesit janë emërtuar siç duhet duke përdorur etiketat e përfshira.	☐
8. Kontrolloni cilësimet e karikuesit për t'u siguruar që cilësimi "Cool Down" dhe "Delay Equalization Charge" janë vendosur në "Off."	☐

Zgjedhja e baterisë tjetër të disponueshme

Mbajini të gjitha bateritë të lidhura derisa të zgjidhen, përveç nëse zgjidhen për mirëmbajtje. Sistemi dallon se kur një bateri është e lidhur me

karikuesin, kur karikuesi fillon dhe përfundon, dhe për sa kohë bateria është e lidhur me karikuesin para se të zgjidhet.

Si të zgjidhni baterinë tjetër të disponueshme:




① Ekrani i TV

Tregon grupimin(et) dhe baterinë tjetër për t'u zgjedhur.



② Ekrani me prekje

Tregon baterinë tjetër për t'u zgjedhur.



③ CMD

Drita LED blu tregon që bateria është e disponueshme për t'u zgjedhur.

Reagimi i sistemit

- Shouteri në kutinë e kontrollit bie me një tingull të këndshëm kur zgjidhet bateria e treguar nga sistemi.
- Shouteri në kutinë e kontrollit bie me një alarm dhe një mesazh kur zgjidhet një bateri e ndryshme nga ajo që tregohet nga sistemi. Kur ndodh kjo, sistemi e konsideron si "zgjedhje të gabuar".
- Të gjitha zgjedhjet e gabuara regjistrohen nga sistemi dhe mund të shihen përmes skedës Historiku tek ekrani kryesor i ekranit me prekje ose nëpërmjet faqes së internetit batterymanagement.net.

Pajisja e Monitorimit të Karikimit (CMD) Treguesit LED vizualë

Figura 4: Treguesit LED për CMD



(Solide) Lidhje e mirë
(Pulson) Lidhje e paqëndrueshme



Karikimi i baterisë



Bateria tjetër për t'u zgjedhur



Defekt në komunikim


* Nëse drita e kuqe e defekteve është e ndezur, ju lutemi ndërroni kabllon e të dhënave.

Ekran me prekje

Sinjal që tregon komunikimin mes ekranit dhe kontrollorit.


Bateria tjetër për t'u marrë për secilën prej grupimeve.

*Ekran kryesor do të shfaqë automatikisht deri në 9 grupime.




Klikoni butonin "To Do" nëse bëhet i kuq - Kontrolloni nëse karikuesit janë në karantinë ose nëse CMD nuk raporton.

A. Statusi




Klikoni **Status** në ekranin kryesor.

* Nëse nuk shfaqet asnjë numër baterie në ekranin kryesor, kontrolloni "Batteries Available" nën Status.




Klikoni **emrin e grupimit (p.sh. PALLET)** për të kontrolluar statusin e baterive në grupim.




Ekran i radhëve tregon statusin e secilit prej karikuesve në grupim.

B. Historiku



Klikoni **History** në ekranin kryesor.
Shfaqen statistikën për shtatë ditët e fundit.



Do të shfaqen detajet e historisë së shtatë ditëve të fundit të karikuesve nën metrikën e zgjedhur.



Zgjidhni **butonin jeshil** për informacione më të hollësishme të baterive të grupimit përkatës.

*Përkufizimi i metrikës


Përzgjedhjet: Numri i baterisë që është zgjedhur për atë grupim.

Zgjedhje të gabuara: Numri i herëve që një bateri është zgjedhur nga grupimi në vend të asaj të zgjedhur nga sistemi.

Zero zgjedhje të disponueshme: Numri i herëve që një bateri është zgjedhur kur asnjë bateri nuk ishte e karikuar plotësisht.


Minimumi i baterive të disponueshme: Një grafik që tregon numrin ditor të baterive të karikuara plotësisht në shtatë ditët e fundit.

C. Për të bërë




Klikoni **To Do** në ekranin kryesor nëse bëhet i kuq.
Kontrolloni nëse ka karikues në karantinë, ndonjë CMD që nuk raporton ose karikues për t'u ndryshuar.

*Numri në kllapa () tregon se sa lajmërimi defektsh ka.




Nëse ka ndonjë lajmërim, do të listohet.

D. Mirëmbajtja




Klikoni **Maintenance** në ekranin kryesor për të zgjedhur bateritë që kanë nevojë për shërbim.

*Ndërkohë që modaliteti i mirëmbajtjes është i aktivizuar, sistemi nuk tregon se cilën bateri të zgjedhë më pas. Por të gjitha zgjedhjet vazhdojnë të regjistrohen.



Kohëzgjatja e modalitetit të mirëmbajtjes mund të vendoset nga 5 deri në 120 minuta. Një kronometër automatik më pas e kthen sistemin në modalitetin normal të punimit.


Modaliteti i mirëmbajtjes mund të anulohet edhe manualisht.




Vendosni **kodin standard 1111** më pas klikoni **OK**.

*Nëse preferoni ta hiqni kodin e vjetër gjatë punës, referojuni pjesës “Ndryshimi i kodeve”.

E. Cilësimet



Klikoni **Settings** në ekranin kryesor.




Vendosni kodin standard **9191** më pas klikoni **OK**.

*Për të ndryshuar kodin, referojuni pjesës “Ndryshimi i kodeve”.

*Referojuni konfigurimit të sistemit për informacion më të hollësishëm.

KONTROLLET DITORE/PËR TURN TË SISTEMIT



Hapi 1

Kontrolloni **Statusin** e sistemit në fillim të ditës ose në fillim të turnit.

Status

Pool Name	Next Battery in Charge	Batteries Available	Charging	Connect Not Charging	No Battery Connected	Quarantine	Unknown
PALLET	-	0	4	1	1	0	0
REACH	-	2	3	3	0	0	0

Time Since Last Upload 09:31:00

Serial Number 4503e6af


2024-04-08 15:26

Hapi 2

Përcaktoni nëse ekzistojnë kushtet e mëposhtme:


1. Nuk ka bateri të disponueshme
2. Bateritë janë të lidhura por nuk karikohen
3. Ka karikues pa bateri të lidhur
4. Ka bateri në karantinë
5. Nuk dihet

**Nëse ekziston ndonjë nga këto kushte, referojuni pjesës "Zgjidhja e problemeve".*



Hapi 3

Nëse "Koha që nga ngarkimi i fundit" thotë 99:59:59, kjo do të thotë që sistemi nuk po ngarkon. Ju lutemi të kontaktoni ofruesin e shërbimit.



Hapi 4


Kontrolloni butonin **To Do** në fillim të ditës ose në fillim të turnit, klikoni për të parë nëse ndonjë lajmërim defekti është i ndezur nëse bëhet i kuq.

LISTA E KONTROLLIT TË OPERIMIT

Detyra	Statusi	
1. A ka bateri të disponueshme?	☐ Po	☐ Jo
<u>Sasia e disponueshme (nëse po)</u> Grupimi 1: __ Grupimi 2: __ Grupimi 3: __ Grupimi 4: __ Grupimi 5: __ Grupimi 6: __ Grupimi 7: __ Grupimi 8: __ Grupimi 9: __		
2. A ka ndonjë grupim pa bateri të disponueshme?	☐ Po	☐ Jo
<u>Lista e Grupimeve (nëse po)</u>		
3. A ka bateri të lidhura por që nuk karikohen?	☐ Po	☐ Jo
<u>Lista e karikuesve (nëse po)</u> <u>Veprimet e kryera</u>		
4. A ka karikues pa bateri të lidhur?	☐ Po	☐ Jo
<u>Lista e karikuesve (nëse po)</u> <u>Veprimet e kryera</u>		
5. A ka karikues në Karantinë?	☐ Po	☐ Jo
<u>Lista e karikuesve (nëse po)</u> <u>Veprimet e kryera</u>		
6. A ka karikues me status të panjohur?	☐ Po	☐ Jo
<u>Lista e karikuesve (nëse po)</u> <u>Veprimet e kryera</u>		
7. Koha që nga ngarkimi i fundit		

ZGJIDHJA E PROBLEMEVE

Në ekran shfaqen vija




Nëse ekрани kryesor shfaq vija në vend të një numri karikuesi, kontrolloni ekranin e Statusit.

Pool Name	Next Battery on Charger	Batteries Available	Charging	Connect Not Charging	No Battery Connected	Quarantine	Unknown
PALLET	104	0	4	1	1	0	0
REACH	205	2	3	3	0	0	0

Time Since Last Upload: 09:31:00
Serial Number: 4503e6af
2024-04-08 15:26

Kontrolloni nëse ka ndonjë bateri të disponueshme.

Zgjidhja e problemeve nga ekрани Statusi



Klikoni **Status** në ekranin kryesor.

Pool Name	Next Battery on Charger	Batteries Available	Charging	Connect Not Charging	No Battery Connected	Quarantine	Unknown
PALLET	104	0	4	1	1	0	0
REACH	205	2	3	3	0	0	0

Time Since Last Upload: 09:31:00
Serial Number: 4503e6af
2024-04-08 15:26

Kur jeni të zgjidhja e problemeve, përqendrohuni te katër kolonat e fundit. **Lidhur nuk karikohet, Asnjë bateri e lidhur, Karantinë dhe Nuk dihet.**

A. Lidhur nuk karikohet

Një bateri sapo është lidhur dhe karikuesi nuk është ndezur ende. OSE një problem me baterinë apo karikuesin i tillë që karikuesi nuk e fillon ciklin e karikimit.

Pool Name	Next Battery on Charger	Batteries Available	Charging	Connect Not Charging	No Battery Connected	Quarantine	Unknown
PALLET	104	0	4	1	1	0	0
REACH	205	2	3	3	0	0	0

Time Since Last Upload: 09:31:00
Serial Number: 4503e6af
2024-04-08 15:26

Kontrolloni nëse:

- ☐ Ndonjë karikues tregon defekt.
- ☐ Drita LED portokalli pulson në CMD, dhe që një bateri është lidhur.
- ☐ Karikuesi është i lidhur me burimin e energjisë nëse ekрани dhe të gjitha dritat treguese në karikues janë bosh.
- ☐ Karikuesi është konfiguruar për nisje me vonesë.
- ☐ Tensioni i baterisë është në gjendje të funksionojë me karikuesin nëse karikuesi funksionon siç duhet, pasi disa karikues nuk e njohin një bateri të shkarkuar tepër.

B. Asnjë bateri e lidhur

Sistemi nuk tregon që është lidhur një bateri.

Status							
Pool Name	Next Battery on Charger	Batteries Available	Charging	Connect Not Charging	No Battery Connected	Quarantine	Unknown
PALLET	104	0	4	1	1	0	0
REACH	205	2	3	3	0	0	0

Time Since Last Upload: 09:31:00
Serial Number: 4503e6af
2024-04-08 15:26

Kontrolloni nëse:

- ☐ Një bateri ndodhet në folenë e karikimit në raftin e baterive.
- ☐ Ka një bateri të lidhur me karikuesin e listuar.
- ☐ Drita LED portokalli në CMD është e ndezur nëse një bateri është lidhur.
- ☐ Drita LED portokalli në CMD nuk është e ndezur edhe nëse është lidhur një bateri. Kontrolloni konektorin e baterisë për t'u siguruar që nuk është prishur.
- ☐ Drita LED portokalli në CMD nuk është e ndezur edhe nëse është lidhur një bateri. Kontrolloni që kunja e FlexiTap në CMD është në mes të kabllos dhe që kunja nuk përthyeret.

C. Karantinë

Kjo tregon sasinë e karikuesve kur një bateri është lidhur, por karikuesi nuk është vënë në punë brenda 24 orësh. Sistemi e karantinon baterinë duke e hequr nga radha, dhe nëse problemi nuk zgjidhet brenda 72 orësh, bateria kthehet në radhë.

Status							
Pool Name	Next Battery on Charger	Batteries Available	Charging	Connect Not Charging	No Battery Connected	Quarantine	Unknown
PALLET	104	0	4	1	1	0	0
REACH	205	2	3	3	0	0	0

Time Since Last Upload: 09:31:00
Serial Number: 4503e6af
2024-04-08 15:26

Kontrolloni nëse:

- ☐ Ndonjë karikues tregon defekt.
- ☐ Drita LED portokalli pulson në CMD, dhe që një bateri është lidhur.
- ☐ Karikuesi është i lidhur me burimin e energjisë nëse ekrani dhe të gjitha dritat treguese në karikues janë bosh.
- ☐ Tensioni i baterisë është në gjendje të funksionojë me karikuesin nëse karikuesi funksionon siç duhet, pasi disa karikues nuk e njohin një bateri të shkarkuar tepër.
- ☐ Për ta hequr një bateri nga karantina, shkëputni baterinë dhe karikuesin dhe lidheni sërish baterinë.

D. Nuk dihet

Tregon numrin e karikuesve që kanë status të panjohur sipas sistemit.

Status							
Pool Name	Next Battery on Charger	Batteries Available	Charging	Connect Not Charging	No Battery Connected	Quarantine	Unknown
PALLET	104	0	4	1	1	0	0
REACH	205	2	3	3	0	0	0

Time Since Last Upload: 09:31:00
Serial Number: 4503e6af
2024-04-08 15:26

Kontrolloni nëse:

- ☐ Drita LED jeshile në CMD është solide. Nëse po, prisni pak minuta dhe kontrolloni përsëri ekranin e Statusit.
- ☐ Drita LED jeshile në CMD nuk është e ndezur. Kontrolloni kabllojt e të dhënave për t'u siguruar që janë të siguruara dhe nuk janë të prishura/shtypura.
- ☐ Drita LED jeshile në CMD nuk është e ndezur. Kontrolloni që kabloja e të dhënave është lidhur në kutinë e kontrollit.
- ☐ Drita LED jeshile në CMD nuk është e ndezur. Kontrolloni që kabloja e të dhënave është lidhur në CMD-në e parë dhe që kabloja është lidhur midis secilit CMD.
- ☐ Drita LED jeshile në CMD nuk është e ndezur. Kontrolloni nëse kutia e kontrollit është lidhur me një burim energjie.
- ☐ Drita LED jeshile në CMD pulson. Kontrolloni që CMD i është caktuar një grupim me anë të konfigurimit të karikuesve.

www.enersys.com

© 2024 EnerSys. Të gjitha të drejtat të rezervuara. Të gjitha markat tregtare dhe logot janë pronë e EnerSys përveç Unistrut, CE, dhe UKCA e cila nuk është pronë e EnerSys. Objekt rishikimi pa njoftim paraprak. E&O.E. R4-25072024

EMEA-AL-OM-EZSELECT-PLUS-0724

